

VENDIM
Nr. 50, datë 27.3.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2MW, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 718, datë 12.10.2016, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier,

konstatoi se:

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213 prot., datë 12.3.2019, ka paraqitur aplikimin, për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik me fuqi të instaluar 2 mw.

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. në cilësinë e mbajtësit të miratimit ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontratën me nr. 6380 rep. dhe nr. 2756 kol., datë 31.12.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik “Smart Watt” sh.p.k. me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier.

Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, pika 4.1.5, germa “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë), germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin), germa “g” (saktësimi mbi dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (në kontratën e qirasë nr. 968 rep. dhe nr. 275 kol., datë 24.5.2018, është konstatuar mungesa e faqes së fundit me nënshkrimet përkatëse).

- Dokumentacioni teknik, për centralet solare: pika 4.4.1. (të dhëna specifike për Centralin Solar të plotësuar nga aplikuesi), pika 4.4.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin të plotësuar nga aplikuesi), pika 4.4.4: dokumentacioni tekniko- ekonomik, germa “a” (Studimi i fizibilitetit), germa “b” (Grafiku i zbatimit të projektit), germa “c” (Oponenca teknike e projektit), germa “d” (Plani i biznesit). Pika 4.5 plotësimin e lejeve të munguara nga institucione të tjera, germa “a”, miratimin e OST-së ose OSHE-së, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes. OSHEE sh.a. në shkresën nr. 26578/1, datë 14.9.2018 ka rekomanduar marrjen e miratimit për pikën e lidhjes nga OST sh.a.

- Subjekti në formatin e aplikimit ka paraqitur të dhënat si vijon: centrali prodhues 2 mw - “Smart Watt” sh.p.k., tipi i centralit solar, tipi i panelave Polikristalin, sipërfaqja e paneleve 30.000 m², orët e punës në një vit 2.010 h/vit, fuqia e instaluar 2 mw, numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar 312x0,0064 mw=2 mw, niveli i tensionit kV=35kV, N/st ku lidhet centrali linja 35/10kV, hoxharë, tensioni i rrjetit të shpërndarjes /t ransmetimi ku lidhet centrali 35 kV. Prodhimi vjetor i energjisë $E_{vjet}=31.36\text{mwh}$, rendimenti 15.5%, viti i ndërtimit 2019, data e fillimit të operimit 2019, jetëgjatësia e centralit 25 vjet. Sa u përket këtyre të dhënave, do t’i kërkohej subjektit sqarimet përkatëse duke qenë se bien ndesh me ato të pasqyruara në studimin e fizibilitetit dhe me kontratën e nënshkruar me MIE-n.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me fuqi të instaluar 2 mw, të ndodhur në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë subjektin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM,
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi